STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për njoftim të menjëhershëm: 3 nëntor 2012

GUVERNATORI CUOMO NJOFTON SE ZËVENDËSOHEN PËR NJUJORKEZËT NDIHMAT SNAP TË DËMTUARA NGA URAGANI SUNDAY

50% e ndihmave mujore u jepen automatikisht përfituesve në komunat Nassau, Orange, Putnam, Rockland, Suffolk, Sullivan, Westchester dhe në pjesë të qytetit të Nju Jorkut

Guvernatori Andrew M. Cuomo njoftoi sot se shteti i Nju Jorkut ka marrë lejen nga Departamenti Amerikan i Bujqësisë për të zëvendësuar ushqimet që kanë humbur përfituesit e Programit të Ndihmës Ushqimore Suplementare (SNAP), të njohur më parë si Food Stamps (kuponat ushqimorë) në zonat e goditura më rëndë nga uragani Sandy. Sipas këtij granti të cilin e kërkoi shteti me ndihmën e qytetit të Nju Jorkut, përfituesit aktualë të SNAP automatikisht do të marrin 50% të përfitimeve mujore për të zëvendësuar ushqimet e humbura si rezultat i stuhisë, duke filluar nga java tjetër. Guvernatori njoftoi gjithashtu se përfituesit e SNAP në këto zona do të kenë mundësi të blejnë ushqime të ngrohta dhe të gatshme me anë të këtyre ndihmave. Shteti i Nju Jorkut do të jetë në gjendje të japë deri në 65 milion dollarë ndihma për të zëvendësuar humbjet.

Qyteti i Nju Jorkut ndihmoi në identifikimin e 77 kodeve postare (zip codes) përfituese që përfshijnë të gjithë Staten Island sipas kërkesës së shtetit për ndihmë. Duke filluar nga java e ardhme, përfituesve të SNAP në këto 77 kode postare dhe në komunat e Nassau, Orange, Putnam, Rockland, Suffolk, Sullivan dhe Westchester, do tu depozitohen automatikisht përfitimet SNAP të muajit tetor në llogarinë e tyre të transferimit elektronik të përfitimeve (Electronic Benefit Transfer (EBT)). Lista e plotë e kodeve postare të qytetit të Nju Jorkut që janë të përfshirë mund të gjendet në otda.ny.gov/news/SNAP-replacements.pdf. Listës mund t'i shtohen edhe kode të tjera postare të qytetit të Nju Jorkut që pësuan ndërprerje të energjisë elektrike sapo të marrim të dhëna më të plota rreth numrit të familjeve të dëmtuara.

"Uragani Sandy la shumë banorë të rajoneve në jug të shtetit të Nju Jorkut pa sendet më të nevojshme si streha dhe ushqimi", tha guvernatori Cuomo. "Zëvendësimi i pjesshëm i përfitimeve SNAP do t'i ndihmojë familjet të zëvendësojnë ushqimet e humbura gjatë stuhisë dhe të mbushin kuzhinat e tyre. Unë e falënderoj Sekretarin e Bujqësisë Tom Vilsack dhe zëvendës sekretarin Kevin Concannon për mbështetjen e tyre dhe për shpejtësinë me të cilën ju përgjigjën kërkesës sonë për ndihmë".

Edhe familjet e tjera përfituese të SNAP të cilat kanë humbur ushqimet e blera me SNAP për shkak të uraganit përfitojnë të marrin ushqime zëvendësuese. Humbja duhet të raportohet deri ditën e mërkurë, 28 nëntor 2012. Familja duhet të dorëzojë një formular të plotësuar dhe të firmosur , që gjendet në otda.ny.gov/programs/applications/2291,pdf, përpara mbylljes së orarit

zyrtar ditën e hënë, 10 dhjetor 2012. Formularin mund ta gjeni edhe në departamentin lokal të zyrës së shërbimeve sociale. Për të gjetur departamentin lokal të shërbimeve sociale, vizitoni otda.ny.gov/workingfamilies/dss.asp, ose merrni në telefon1-800-342-3009.

Përfituesit e SNAP në qytetin e Nju Jorkut dhe në komunat e Nassau, Orange, Putnam, Rockland, Suffolk, Sullivan dhe Westchester do të kenë mundësi të përdorin përfitimet (benefits) për të blerë ushqime të ngrohta dhe të gatshme, duke ditur se shumë njujorkezë nuk kishin energji elektrike ose janë shpërngulur si pasojë e stuhisë dhe nuk kanë mundësi për të ruajtur ushqimet apo për të gatuar. Në situatë normale, sipas rregullave federale, nuk lejohet blerja e këtyre ushqimeve me anë të përfitimeve SNAP. Ushqimet duhet të blihen te shitës të autorizuar, si supermarketet të cilat pranojnë EBT. Departamenti Amerikan i Bujqësisë na e miratoi kërkesën për këtë gjë për shtetin e Nju Jorkut. Ky miratim hyn në fuqi menjëherë dhe skadon më 30 nëntor 2012.

Familjet që nuk marrin ndihmë SNAP mund të shohin në përfitojnë fare lehtë e shpejt dhe të aplikojnë në online, duke vizituar myBenefits.ny.gov. Njujorkezët mund të përdorin edhe ACCESS NYC të Nju Jorkut, një shërbim online për banorët e Nju Jorkut për të aplikuar për SNAP si dhe për programet e tjera të ndihmës nga qyteti, shteti dhe ato federale.

###

Lajme të tjera do t'i gjeni në wwww.governor.ny.gov
Dhoma Ekzekutive e shtetit të Nju Jorkut (New York State | Executive Chamber)|
press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418